



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine – Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

UDHËZIM ADMINISTRATIV(MINT) NR. 01/2021 PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE

ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MIET) NO. 01/2021 ON THE REGISTRATION OF BUSINESS ORGANIZATIONS

ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MIPT) BR. 01/2021 O REGISTRACIJI POSLOVNIH DRUŠTAVA



<p>Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë</p> <p>Mbështetur në nenin 17 paragrafi 12 të Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare (Gazeta Zyrtare nr. 9, 24.05.2018), nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 dhe shtojcën 12 të Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare, 30.03.2021), si dhe nenin 38 paragrafi 6 të Rregullores nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 15, 12.09.2011),</p> <p>nxjerr:</p> <p>UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) NR. 01/2021 PËR REGJISTRIMIN E SHOQËRIVE TREGTARE</p>	<p>Minister of Industry, Entrepreneurship and Trade</p> <p>Pursuant to article 17, paragraph 12 of the Law No. 06/L-016 on Business Organisations (Official Gazette No. 9, 24.05.2018), Article 8, paragraph 1 sub-paragraph 1.4, Annex 12 of Regulation (GRK) No. 02/2021 on the Areas of Administrative Responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries (Official Gazette, 30.03.2021), as well as Article 38, paragraph 6, of Regulation No. 09/2011, of the Government of the Republic of Kosovo (Official Gazette No.15, 12.09.2011),</p> <p>Issues:</p> <p>ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MIET) NO. 01/2021 ON THE REGISTRATION OF BUSI- NESS ORGANIZATIONS</p>	<p>Ministarka Industrije, Preduzetništva i Trgovine</p> <p>U skladu sa člana 17. stav 12. Zakona br. 06/L-016 o poslovnim društvima (SL, br. 9 od 24. maja 2018.), članu 8 stav 1 podstav 1.4. Aneks 12 Uredbe (VRK) br. 02/2021 o Oblastima Administrativne Odgovornosti Kancelarije Premijera i Ministarstava, i člana 38, stav 6 Pravilnika Br.09/2011 o Radu Vlade Republike Kosovo, (Službeni List br.15,12.09.2011),</p> <p>Donosi:</p> <p>ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO (MIPT) BR. 01/2021 O REGISTRACIJI POSLOVNIH DRUŠTAVA</p>
--	--	--



<p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është rregullimi i mënyrës dhe procedurës së regjistrimit dhe ndryshimit të të dhënave të shoqërive tregtare.</p>	<p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p> <p>The purpose of this Administrative Instruction is to regulate the manner and procedure of the registration and amendment of eventual data of Business Organisations.</p>	<p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p> <p>Cilj ovog Administrativnog uputstva je da reguliše način i postupak registracije i promene eventualnih podataka poslovnih društava.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Ky Udhëzim Administrativ zbatohet për regjistrimin dhe ndryshimin e të dhënave nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (tutje: ARBK), për të gjitha Shoqëritë Tregtare dhe subjektet tjera të përcaktuara në nenin 23 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p> <p>This Administrative Instruction applies to the registration and changing of data by the Kosovo Business Registration Agency (hereinafter: KBRA) for all Business Organization and other entities defined in Article 23 of the Law No. 06/L-016 on Business Organizations.</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Delokrug</p> <p>Ovo Administrativno Uputstvo se sprovodi na registraciju i promenu podataka od strane Kosovske Agencije za Registraciju Biznisa (u daljem tekstu: KARB), za sva Poslovna Društva i druge subjekte navedene u članu 23. Zakona br. 06/L-016 o Poslovnim Društvima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p> <p>1. Termat dhe shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këto kuptime, përveç nëse konteksti përcakton ndryshe:</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p> <p>1. Each of the terms and expressions used in this Administrative Instruction shall have the meaning set forth below, unless the context in which these terms appear have different meaning:</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p> <p>1. Svaki od pojmova i izraza koji se koriste u ovom Administrativnom uputstvu ima značenje koje je navedeno u nastavku, osim ako kontekst u kojem se ovi pojmovi pojavljuju ima drugačije značenje:</p>



<p>1.1. Ligji – Ligji nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;</p> <p>1.2. Parashtruesi – Pronari, Përfaqësuesi i Autorizuar apo Përfaqësuesi me Prokurë i cili parashtron kërkesë në ARBK për përfshirjen apo ndryshimin e të dhënave në regjistër.</p> <p>2. Termat dhe shprehjet e tjera të përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë të njëjtin kuptim siç përcaktohet në Ligj.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Mënyra dhe procedura e regjistrimit fillestar dhe ndryshimeve të të dhënave të Shoqërive Tregtare</p> <p>1. Për regjistrimin e Shoqërisë Tregtare, Parashtruesi mund të aplikojë në komunën në të cilën vepron ose në zyrën qendrore të ARBK-së në Prishtinë.</p> <p>2. ARBK bën regjistrimin fillestar, regjistrimet e tjera dhe ndryshimin dhe plotësimin e të dhë-</p>	<p>1.1. Law – Law No. 06/L-016 on Business Organisations;</p> <p>1.2. Applicant – Owner, authorized representative or authorized proxy who submits the request to KBRA for inclusion or amendment of data in the registry.</p> <p>2. Other terms and expressions used in this Administrative Instruction shall have the same meaning as determined in the Law.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Manner and procedure of initial registration and amendment of data of Business Organisations</p> <p>1. For the registration of the Company, the Applicant may apply to the Municipality in which he operates, or to the Municipality of Prishtina as a center.</p> <p>2. KBRA shall make the initial registration, other registrations and amendments and supplementation of the existing data of Business</p>	<p>1.1. Zakon – Zakon br. 06/L-016 o poslovnim društva;</p> <p>1.2. Podnosilac – Vlasnik, ovlašćeni zastupnik ili zastupnik sa ovlašćenjem koji podnosi zahtev KARB-u za uključivanje ili promenu podataka u registru.</p> <p>1. Ostali pojmovi i izrazi koji se koriste u ovom Administrativnom uputstvu imaju isto značenje koje je određeno zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Način i postupak početne registracije i promene podataka poslovnih društava</p> <p>1. Za registraciju komercijalnog preduzeća, podnosilac zahteva može da podnese zahtev za opštinu u kojoj posluje, ili za opštinu Priština kao centar.</p> <p>2. KARB vrši početnu registraciju, druge registracije i promenu i dopunu postojećih podataka poslovnih društava ukoliko se</p>
--	--	--



<p>nave ekzistuese të Shoqërive Tregtare nëse dorëzohen të gjitha dokumentet që kërkohen me Ligj, ligjet e tjera dhe këtë Udhëzim Administrativ.</p>	<p>Organisations if all the documents that comply with the requirements of the Law on Business Organizations, other applicable laws and this Administrative Instruction are submitted.</p>	<p>podnesu sva dokumenta koja su u skladu sa zahtevima Zakona o poslovnim društvima, drugim važećim zakonima i ovim Administrativnim uputstvom.</p>
<p>3. Lista e dokumenteve të kërkuara për regjistrimin fillestar është specifike për forma të ndryshme ligjore të Shoqërive Tregtare të parapara në Kapitullin V dhe Kapitullin VI të Ligjit.</p>	<p>3.The list of documents required for initial registration is specific to the various legal forms of Business Organizations set forth in Chapter V and Chapter VI of the Law.</p>	<p>3.Lista sa dokumentima koji su potrebni za početnu registraciju specifična je za različite pravne oblike poslovnih društava predviđenih u Poglavlju V i Poglavlju VI Zakona.</p>
<p>4. Lista e dokumenteve të kërkuara për ndryshimin e të dhënave është specifike për forma të ndryshme ligjore të Shoqërive Tregtare të parapara në Kapitullin VII të Ligjit.</p>	<p>4.The list of documents required for amendment of data is specific to the various legal forms of Business Organizations set forth in Chapter VII of the Law.</p>	<p>4.Lista sa potrebnim dokumentima za promenu podataka specifična je za različite pravne oblike poslovnih društava navedenih u Poglavlju VII Zakona.</p>
<p>5.Me rastin e ndryshimit të adresës të Shoqërisë Tregtare ose cilës do formë tjetër të organizimit që regjistrohet në ARBK sipas Ligjit, Parashtruesi obligohet ta kthej në ARBK certifikatën origjinale paraprake të regjistrimit, ose dëshminë se certifikata është shpallur e pavlefshme në njërën nga gazetatat ditore.</p>	<p>5.Upon a change of Business Organization's address or any other form of organization that is registered with the KBRA under the Law, the Applicant shall be obliged to return to the KBRA the original preliminary registration certificate, or evidence that the certificate has been declared invalid in one of the daily newspapers.</p>	<p>5.U slučaju promene adrese poslovnih društava ili bilo kog drugog oblika organizacije koja je registrovana u KARB prema Zakonu, podnosilac je dužan da vrati KARB-u originalnu potvrdu o preliminarnoj registraciji ili dokaz da je potvrda proglašena nevažećom u nekoj od dnevnih novina.</p>



Neni 5 Regjistrimi fillestar dhe ndryshimi i të dhënave të Biznesit Individual	Article 5 Initial registration and amendment of data of the Individual Business	Član 5 Početna registracija i promena podataka pojedinačnog biznisa
<p>1.Për regjistrimin e Biznesit Individual, Parashtruesi duhet të plotësojë dhe të dorëzojë në ARBK:</p> <p>1.1.Formularin përkatës për regjistrimin e Biznesit Individual;</p> <p>1.2. Fotokopjen e dokumentit personal të identifikimit të Pronarit, Përfaqësuesit të Autorizuar ose Përfaqësuesit me Prokurë.</p> <p>2.Nëse ka ndryshime në të dhënat të cilat janë regjistruar në ARBK për Biznesin Individual ose nëse pronari dëshiron që t'i ndryshojë këto të dhëna, Parashtruesi duhet të plotësojë dhe të dorëzojë në ARBK:</p> <p>2.1. Formularin përkatës për ndryshimin e të dhënave të Biznesit Individual;</p> <p>2.2. Fotokopjen e dokumentit personal të identifikimit të Parashtruesit – nëse Pronari është shtetas i huaj, atëherë fotokopja e pasaportës;</p>	<p>1.To register an Individual Business, the Applicant shall complete and submit to KBRA the following:</p> <p>1.1.The relevant form for registration of individual business;</p> <p>1.2 Photocopy of personal identification document of the owner, authorized representative or authorized proxy.</p> <p>2.In case of amendments to the data registered with KBRA for Individual Business or if the owner wishes to amend this data, the applicant shall complete and submit to KBRA the following:</p> <p>2.1 The relevant form for amendment of data of the Individual Business;</p> <p>2.2. Photocopy of the personal identification document of the applicant. If the Owner is a foreign citizen then a photocopy of the passport;</p>	<p>1.Za registraciju Pojedinačnog Biznisa, podnosilac zahteva treba da popuni i podnese u KARB:</p> <p>1.1.Odgovarajući obrazac za registraciju pojedinačnog biznisa;</p> <p>1.2.Fotokopiju ličnog identifikacionog dokumenta vlasnika,Ovlašćenog zastupnika ili Zastupnika sa ovlašćenjem.</p> <p>2. Ako postoje bilo kakve promene u podacima koji su registrovani u KARB za Pojedinačni Biznis ili ako vlasnik želi da promeni ove podatke, Vlasnik, podnosilac zahteva treba da popuni i podnese u KARB:</p> <p>2.1.Odgovarajući obrazac za promenu podataka o pojedinačnom biznisu;</p> <p>2.2. Fotokopija ličnog dokumenta podnosioca zahteva. Ako je Vlasnik strani državljanin, onda fotokopiju pasoša.</p>



<p>2.3. Fletëpagesën që është paraparë me Udhëzimin Administrativ për Përcaktimin e Taksave për Shërbimet e Ofruara nga ARBK.</p> <p>3. Tek Biznesi Individual lejohet transferimi i Emrit Tregtar siç përcaktohet me Udhëzimin Administrativ të Emrit Zyrtar dhe Emrit Tregtar të Shoqërive Tregtare dhe nuk lejohet ndërrimi i pronarit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Regjistrimi fillestar dhe ndryshimi i të dhënave i Ortakërisë së Përgjithshme</p> <p>1.Për Regjistrimin e Ortakërisë së Përgjithshme, Parashtruesi duhet të plotësojë dhe të dorëzojë në ARBK:</p> <p>1.1.Formularin përkatës për regjistrimin e Ortakërisë së Përgjithshme;</p> <p>1.2. Fotokopjen e dokumentit personal të identifikimit të Ortakëve si dhe Përfaqësuesit të Autorizuar ose Përfaqësuesit me Prokurë –</p>	<p>2.3 Payment slip provided for in the Administrative Instruction on Determination of Fees for Services Provided by the KBRA.</p> <p>3. The Individual Business shall be allowed to transfer the Trade Name as defined by the Administrative Instruction on the Official Name and Trade Name of the Business Organisations and the change of owner shall not be allowed.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Initial registration and amendment of data of the General Partnership</p> <p>1.For registration of the General Partnership, the applicant shall complete and submit to KBRA the following:</p> <p>1.1. The relevant form for the registration of General Partnership;</p> <p>1.2. Photocopy of the personal identification document of the Partners as well as the Authorized Representative or the Authorized</p>	<p>2.3.Uplatnicu koja je predviđena Administrativnim uputstvom o određivanju taksi za usluge koje pruža KARB.</p> <p>3. Pojedinačnim biznisiima dozvoljen je prenos trgovačkog imena kako je utvrđeno Administrativnim uputstvom službenog imena i trgovačkog imena poslovnih društava i nije dozvoljena promena vlasnika.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Početna registracija i promena podataka opšteg partnerstva</p> <p>1.Za registraciju Opšteg Partnerstva, podnosilac zahteva treba da popuni i podnese u KARB:</p> <p>1.1.Odgovarajući obrazac za registraciju opšteg partnerstva;</p> <p>1.2. Fotokopija ličnog dokumenta Partnera, kao i Ovlašćenog Predstavnik ili Opunomoćnika. Ako je Partner strani državljanin, onda fotokopiju pasoša.</p>
---	---	---



<p>nëse Ortaku është shtetas i huaj atëherë fotokopja e pasaportës;</p> <p>1.3. Marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme të nënshkruar nga të gjithë Ortakët e Përgjithshëm.</p> <p>2.Nëse ka ndryshime në të dhënat e regjistruara ose në marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme të dorëzuar në ARBK, Përfaqësuesi i Autorizuar ose Përfaqësuesi me Prokurë duhet të plotësojë dhe të dorëzojë në ARBK:</p> <p>2.1. Formularin përkatës për ndryshimin e të dhënave të Ortakërisë së Përgjithshme;</p> <p>2.2. Fotokopjen e dokumentit personal të identifikimit të Përfaqësuesit të Autorizuar ose Përfaqësuesit me Prokurë;</p> <p>2.3. Vendimi i miratuar nga ortakët e përgjithshëm për ndryshimin dhe plotësimin e të dhënave ose marrëveshjes së Ortakërisë së Përgjithshme;</p>	<p>Proxy. If the Partner is a foreign citizen then a photocopy of the passport;</p> <p>1.3 Agreement of General Partnership signed by all General Partners.</p> <p>2.In case of amendments to the registered data or to the agreement of the General Partnership submitted to the KBRA, the authorized representative or authorized proxy shall complete and submit to the KBRA the following:</p> <p>2.1 The relevant form for amendment of the data of the General Partnership;</p> <p>2.2. Photocopy of personal identification document of the authorized representative or authorized proxy;</p> <p>2.3. The decision approved by the General Partners on amending and supplementing the data or agreement of the General Partnership;</p>	<p>1.3.Sporazum o opštem partnerstvu potpisan od svih opštih partnera.</p> <p>2.Ako nema promena u registrovanim podacima ili u sporazumu o opštem partnerstvu koji je podnesen u KARB, ovlašćeni zastupnik ili zastupnik sa ovlašćenjem treba da popuni i podnese u KARB:</p> <p>2.1.Odgovarajući obrazac za promenu podataka o opštem partnerstvu;</p> <p>2.2.Fotokopiju ličnog identifikacionog dokumenta ovlašćenog zastupnika ili zastupnika sa ovlašćenjem;</p> <p>2.3.Odluku usvojenu od opštih partnera za promenu i dopunu podataka ili sporazuma o opštem partnerstvu;</p>
---	---	--



<p>2.4. Nëse ndryshimet janë bërë në marrëveshjen e Ortakërisë së Përgjithshme, atëherë bashkëngjitet teksti i plotë i marrëveshjes me ndryshime;</p> <p>2.5.Fletëpagesën që është paraparë me Udhëzimin Administrativ për përcaktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga ARBK.</p> <p>3. Bizneset Individuale tashmë të regjistruara në regjistrin e ARBK me më shumë se një pronar korrigjohen nga ARBK dhe kthehen në Ortakëri të Përgjithshme, si dhe Ortakëritë e Përgjithshme me vetëm një pronar korrigjohen nga ARBK dhe kthehen në Biznese Individuale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Regjistrimi fillestar dhe ndryshimi i të dhënave i Ortakërisë së Kufizuar</p> <p>1. Për regjistrimin e Ortakërisë së Kufizuar, parashtruesi duhet të plotësojë dhe të dorëzojë në ARBK:</p> <p>1.1.Formularin përkatës për regjistrimin e Ortakërisë së Kufizuar;</p>	<p>2.4. In case of amendments to the agreement of the General Partnership, then the full text of the amended agreement shall be attached;</p> <p>2.5.Payment slip provided for in the Administrative Instruction on Determination of Fees for Services Provided by the KBRA.</p> <p>3. Individual Businesses already registered in the KBRA register with more than one owner shall be corrected by KBRA and returned to General Partnerships, and the General Partnerships with only one owner shall be corrected by KBRA and returned to Individual Businesses.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Initial registration and amendments of the data of the Limited Partnership</p> <p>1. For registration of the Limited Partnership, the applicant shall complete and submit to the KBRA the following:</p> <p>1.1.The relevant form for registration of the Limited Partnership;</p>	<p>2.4.Ako su promene izvršene u sporazumu o opštem partnerstvu, prilaže se potpuni tekst sporazuma sa promenama;</p> <p>2.5.Uplatnicu koja je predviđena Administrativnim uputstvom za određivanje taksi za usluge koje pruža KARB.</p> <p>3.Pojedinačni biznisi koji su već registrovani sa više od jednog vlasnika u registru KARB, KARB ih ispravlja i vraća u opšte partnerstvo, kao i opšta partnerstva sa samo jednim vlasnikom, KARB ispravlja i vraća u pojedinačne biznise.</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Početna registracija i promena podataka ograničenog partnerstva</p> <p>1. Za registraciju Ograničenog Partnerstva, podnosilac zahteva treba da popuni i podnese u KARB:</p> <p>1.1.Odgovarajući obrazac za registraciju ograničenog partnerstva;</p>
---	---	--



<p>1.2. Fotokopjen e dokumentit personal të identifikimit të Ortakëve si dhe Përfaqësuesit të Autorizuar ose Përfaqësuesit me Prokurë – nëse Ortaku është shtetas i huaj atëherë fotokopjen e pasaportës;</p> <p>1.3.Marrëveshjen e Ortakërisë së Kufizuar të nënshkruar nga të gjithë ortakët.</p> <p>2. Nëse ka ndryshime në të dhënat e regjistruara në ARBK ose marrëveshjen e Ortakërisë së Kufizuar, Parashtruesi duhet të plotësojë dhe të dorëzojë në ARBK:</p> <p>2.1.Formularin apo formularët përkatës për ndryshimin e të dhënave të Ortakërisë së Kufizuar;</p> <p>2.2. Fotokopjen e dokumentit personal të identifikimit të Ortakëve, Përfaqësuesit të Autorizuar ose Përfaqësuesit me Prokurë. Nëse është shtetas i huaj atëherë fotokopja e pasaportës;</p>	<p>1.2.Photocopy of the personal identification document of the Partners as well as the Authorized Representative or Authorized Proxy. if the Partner is a foreign citizen then a photocopy of the passport;</p> <p>1.3.Agreement of the Limited Partnership signed by all partners.</p> <p>2. In case of amendments to the data registered in the KBRA or the agreement of Limited Partnership, the applicant shall complete and submit to the KBRA the following:</p> <p>2.1.The relevant form or forms for amendments to the data of Limited Partnership;</p> <p>2.2. Photocopy of the personal identification document of Partners, Authorized Representative or Authorized Proxy. If it is a foreign citizen then a photocopy of passport;</p>	<p>1.2. Fotokopija ličnog dokumenta Partnera, kao i Ovlašćenog Predstavnika ili Opunomoćnika. Ako je Partner strani državljanin, onda fotokopiju pasoša;</p> <p>1.3.Sporazum o ograničenom partnerstvu, potpisan od svih partnera.</p> <p>2. Ako ima promena u podacima koji su registrovani u KARB ili sporazumu o Ograničenom Partnerstvu, podnosilac zahteva treba da popuni ili podnese u KARB:</p> <p>2.1.Obrazac ili odgovarajuće obrasce za promenu podataka o ograničenom partnerstvu;</p> <p>2.2. Fotokopija ličnog dokumenta Partnera, Ovlašćenog Predstavnika ili Opunomoćnika. Ako je strani državljanin, onda fotokopiju pasoša;</p>
---	---	---



<p>2.3.Vendimin e miratuar nga ortakët për ndryshimin dhe plotësimin e të dhënave ose marrëveshjes së Ortakërisë së Kufizuar;</p> <p>2.4.Nëse ndryshimet janë bërë në marrëveshjen e Ortakërisë së Kufizuar, atëherë bashkëngjitet teksti i plotë i marrëveshjes me ndryshime;</p> <p>2.5.Fletëpagesën që është paraparë me Udhëzimin Administrativ për përcaktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga ARBK.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Regjistrimi fillestar dhe ndryshimi i të dhënave të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar</p> <p>1.Për Regjistrimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, parashtruesi duhet të plotësojë dhe dorëzojë në ARBK:</p> <p>1.1.Formularin përkatës për regjistrimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar;</p>	<p>2.3. Decision approved by the Partners to amend and supplement the data or agreement of the Limited Partnership;</p> <p>2.4. In case of amendments to the agreement of the Limited Partnership, then the full text of the amended agreement shall be attached;</p> <p>2.5.Payment slip provided for in the Administrative Instruction on Determination of Fees for Services Provided by the KBRA.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Initial registration and amendment of the data of Limited Liability Company</p> <p>1.For the registration of a Limited Liability Company, the applicant shall complete and submit to the KBRA the following:</p> <p>1.1.The relevant form for registration of a Limited Liability Company;</p>	<p>2.3 Odluku usvojenu od partnera za promenu i dopunu podataka ili sporazum o ograničenom partnerstvu;</p> <p>2.4. Ako su promene izvršene u sporazumu o ograničenom partnerstvu, prilaže se potpuni tekst sporazuma sa promenama;</p> <p>2.5.Uplatnica koja je predviđena Administrativnim uputstvom o određivanju taksi za usluge koje pruža KARB.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Početna registracija i promena podataka društva sa ograničenom odgovornošću</p> <p>1.Za registraciju Društva sa Ograničenom Odgovornošću, podnosilac zahteva treba da popuni i podnese u KARB:</p> <p>1.1.Odgovarajući obrazac za registraciju društva sa ograničenom odgovornošću;</p>
--	--	---



<p>1.2. Fotokopjen e dokumentit personal të identifikimit të Themeluesve si dhe Përfaqësuesit të Autorizuar ose Përfaqësuesit me Prokurë – nëse Aksionari është shtetas i huaj atëherë fotokopja e pasaportës; kur aksionar është një Shoqëri Tregtare, certifikata e regjistrimit në Kosovë, nëse themelues është Shoqëria e Huaj Tregtare, certifikata e regjistrimit dhe informatat e biznesit jo më të vjetra se tre (3) muaj;</p> <p>1.3. Statutin e Shoqërisë më Përgjegjësi të Kufizuar si shtojcë e marrëveshjes së inkuorporimit;</p> <p>1.4. Marrëveshjen e inkuorporimit, nënshkruar nga të gjithë themeluesit ose aktin e themelimit, nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar ka vetëm një themelues; statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar si shtojcë e marrëveshjes së inkuorporimit nënshkruar nga themeluesit;</p> <p>2. Nëse ka ndryshime në të dhënat e regjistruara në ARBK apo në statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, Parashtruesi duhet të dorëzojë në ARBK:</p>	<p>1.2. Photocopy of the personal identification document of the founders, as well as of the authorized representative or authorized proxy. If the Shareholder is a foreign citizen then a photocopy of the passport. When a Business Organisation is shareholder, the registration certificate in Kosovo, if the founder is a Foreign Business Organisation, then the registration certificate and business information not older than three (3) months;</p> <p>1.3. Statute of the Limited Liability Company as annex to the incorporation agreement.</p> <p>1.4. Incorporation agreement, signed by all the founders or the founding act if the Limited Liability Company has only one founder. Statute of the Limited Liability Company as annex to the incorporation agreement signed by the founders;</p> <p>2. In case of amendments to the data registered in the KBRA or the Statute of a Limited Liability Company, the applicant shall submit to the KBRA:</p>	<p>1.2. Fotokopiju ličnog identifikacionog dokumenta Osnivača i ovlašćenog zastupnika ili zastupnika sa ovlašćenjem. Ako je Akcionar strani državljanin, onda fotokopiju pasoša. Kada je akcionar poslovno društvo, sertifikat o registraciji na Kosovu, ako je osnivač strano poslovno društvo, sertifikat o registraciji ili informacije o biznisu koje nisu starije od tri (3) meseca;</p> <p>1.3. Statut društva sa ograničenom odgovornošću kao prilog sporazumu o inkuorporaciji.</p> <p>1.4. Sporazum o inkuorporaciji, potpisan od svih osnivača ili akt o osnivanju ako društvo sa ograničenom odgovornošću ima samo jednog osnivača. Statut Društva sa Ograničenom Odgovornošću kao aneks Ugovora inkuorporacije, potpisan od strane osnivača;</p> <p>2. Ako ima promena u podacima koji su registrovani u KARB ili u statutu Društva sa Ograničenom Odgovornošću, podnosilac zahteva treba da podnese u KARB:</p>
---	---	--



<p>2.1. Formularin apo formularët përkatës për ndryshimin e të dhënave të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar;</p> <p>2.2. Vendimin e miratuar nga Aksionarët për ndryshimin dhe plotësimin e të dhënave ose statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar;</p> <p>2.3. Nëse ndryshimet janë bërë në Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, atëherë bashkëngjitet teksti i plotë i Statutit me ndryshime;</p> <p>2.4. Fotokopjen e dokumentit personal të identifikimit të parashtruesit;</p> <p>2.5. Nëse ka ndërrim të pronarëve atëherë duhet të dorëzojë fotokopjen e identifikimit të dokumentit personal të pronarëve të ri.</p> <p>2.6. Nëse Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar ka kapital themeltar sipas Statutit e nëse dëshiron ta zvogëlon kapitalin themeltar zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e Ligjit.</p>	<p>2.1. The relevant form or forms for amending the data of Limited Liability Company;</p> <p>2.2. The decision approved by Shareholders for amending and supplementing of data or statute of the Limited Liability Company;</p> <p>2.3. In case of amendments to the Statute of the Limited Liability Company, then the full text of the amended Statute shall be attached;</p> <p>2.4. Photocopy of personal identification document of the applicant;</p> <p>2.5. In case the owners change, then photocopy of the new owners' personal identification documents shall be submitted.</p> <p>2.6. The provisions of Article 147 of Law no. 06/L-016 on Business Organizations shall apply when the Limited Liability Company has a charter capital under the Statute and wishes to decrease its charter capital.</p>	<p>2.1. Odgovarajući obrazac ili obrasce za promenu podataka društva sa ograničenom odgovornošću;</p> <p>2.2. Odluku koju su usvojili akcionari za izmenu i dopunu podataka ili statuta društva sa ograničenom odgovornošću;</p> <p>2.3. Ako su izmene izvršene u statutu društva sa ograničenom odgovornošću onda se prilaže puni tekst Statuta sa promenama;</p> <p>2.4. Fotokopiju ličnog identifikacionog dokumenta podnosioca zahteva;</p> <p>2.5. Ako postoji promena vlasnika onda se podnosi fotokopija ličnog identifikacionog dokumenta novih vlasnika.</p> <p>2.6. Ako društvo sa ograničenom odgovornošću ima osnivački kapital u skladu sa Statutom međutim traži da se taj osnivački kapital smanji, primenjivaće se povoljno odredbe Zakona br. 06/L-016 o Poslovnim Društvima.</p>
---	--	--



